



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:237514

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05503412

C-IV-13-3085

Ankuesi

E (S) A1, P

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari i çështjes Sylejman Shumolli me 26 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI095-0517, të datës 02 tetor 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 06 nëntor 2013, ankuesi E (S) A1 – djali i S A2 (tani më i ndjerë), dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. GJI095-0517 datë 02 tetor 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensimin e pagave të papaguara në shumë prej 15,200.00 € për periudhën gusht 1991 – dhjetor 1997, nga NSH “Banja e Kllokotit” (në likuidim). Ankuesi theksoi se me vendimin e atakuar në ankesë është refuzuar kërkesa e tij edhe pse e njëjta është ushtruar me kohë. Në arsyetimin e të njëjtit thuhet se ka ardhur deri te parashkrimi i kërkesës për shkak të afatit dhe se gjoja nuk ka prova për parashkrimin e të njëjtës. Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike i njëjti ka parashtruar provat e tij materiale me të cilat vërtetohet se ai me kohë i është drejtuar organeve kompetente për realizimin e të drejtave të tij. Ankuesi i propozon gjykatës që ankesa e tij të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe vendimi i AKP-së të ndryshohet në atë mënyrë që ankuesit t’i kompensohen të gjitha pagat e papaguara për periudhën gusht 1991 – dhjetor 1997 në shumë prej 15,200.00 € nga

ndërmarrja në likuidim NSH “Banja e Kllokotit” sepse nuk ka parashkrim të kërkesës nga se ai me kohë ka ushtruar ankesë organit kompetent. Ankuesi në mbështetje të ankesës së tij ka bashkangjitur dëshmitë si: Aktvendimin mbi pushimin pa pagesë të lëshuar nga NSH “Banja e Kllokotit” nr. 424 datë 03 maj 1991, Ankesën ndaj vendimit nr.796 të datës 19 gusht 1991 drejtuar organit të përkohshëm të NSH “Banja e Kllokotit”, Aktvendimin mbi caktimin e punëtorit në punë nr. 203 datë 17 shkurt 1983 lëshuar nga NSH, Certifikatën e vdekjes nr. ..datë . nëntor .. për të ndjerin S A, Vendimin mbi hedhjen e kundërshtimit të punëtorit nr. 1061, datë 03 tetor 1991 dhe Aktvendimin për ndërprerjen e procedurës, lëshuar nga Gjykata Komunale në Viti C. nr. 51/2011 datë 13 prill 2011.

Më 11 tetor 2018, e paditura AKP-ja si përfaqësuese ligjore e të paditurës, i kundërshton të gjitha pretendimet e ankuesit të paraqitura në ankesën e tij duke i konsideruar si të pabazuara në ligj dhe si e tillë duhet të refuzohet. Propozimi i ankuesit nuk e përmban bazën ligjore, e as një listë të provave mbi të cilën do ta mbështeste propozimin e tij, andaj propozimi i tij nuk përmban të gjitha elementet që parashihen me nenin 27 pika 2.4, të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-033 për DHPGJS, si dhe nenit 253 të LPK nr.03/L-006. Ankuesi nuk ka prezantuar fakte në kuptim të nenit 7 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore ku theksohet se *“Palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova më të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Ankuesi ankesën ndaj vendimit të AL-së e atakon për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Në procedurën e likuidimit ankuesi, kishte parashtruar kërkesë për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën gusht 1991 – dhjetor 1997, në shumën prej 15,200.00 €. Agjencia mbështet vendimin e AL-së mbi bazën e arsytimit të refuzimit të kërkesës siç parashihet me Shtojcën e Ligjit nr. 04/L-034 të nenit 36.2.1 kur kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme, si dhe në bazë të Ligjit të Punës së Bashkuar (GZ nr. 53/1976) nenit 608, i cili thekson se: *“pagesa e shumës pagës, apo rrogës, apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet”*. Sipas këtij neni kërkesa duhet të jetë e parashtruar në gjykatë brenda tre vjetësh apo autoritet tjetër, nga koha kur NSH pretendohet të këtë dështuar të përmbush obligimin ndaj parashtruesit i cili rrjedh nga marrëdhënia e punës. Që është tre vjet nga viti 1991 kur parashtruesi nuk ka marrë pagat, Agjencia nuk ka dëshmi se parashtruesi ka paraqitur kërkesë për paga të papaguara para një gjykate apo autoriteti tjetër brenda tre vjetësh. Në bazë të nenit 608 të LPB-së, DHPGJS me Aktgjykimin C-II-16-0153, ka refuzuar padinë e paditësve si të pa bazuar. Në përfundim, Agjencia konsideron se pretendimet e paraqitura në ankesë, nuk janë të mbështetura me dëshmi dhe fakte materiale që do të ishin relevante për rastin konkret dhe mungesat e tilla, ankesën e bëjnë të paqëndrueshme. E paditura i propozon gjykatës që të hedhet poshtë ankesa e ankuesit si e papranueshme E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj ka bashkangjitur vendimin e kundërshtuar.

Më 05 nëntor 2018, ankuesi dorëzoi përgjigjen e tij ndaj mbrojtjes së të paditurës.

Më 09 nëntor 2018, e paditura ka dorëzuar kundërpërgjigjen e saj.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se njëra ndër çështjet thelbësore kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit, që si e tillë është çështje e rregulluar me dispozita ligjore dhe meqenëse gjykata konstaton se është parashkruar e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore përmbushjen e detyrimit, pretendimet e tjera të palëve nuk do të shqyrtohen.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh:

kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi;

Gjykata gjen se neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76) në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së ishte shfuqizuar me Ligjin mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Ndërmarrjet (GZ 40/89) i cili ligj kishte hyrë në fuqi me 15 korrik 1989, konkretisht me nenin 74, i cili nen e plotëson Ligjin mbi Ndërmarrjet (GZ 77/88, (i cili kishte hyrë në fuqi me 01 janar 1989), konkretisht nenin 196 i cili qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha dispozitave të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, përveç dispozitave nga Kreu IV dhe Kreu i VI kaptina 2, dispozita e nenit 608 është e vendosur në Kreun e VI në kaptinën e 3, që do të thotë se është shfuqizuar me këtë ndryshim plotësim të ligjit. Ligji mbi Marrëdhënien e Punës i datës 14 prill 1989 dhe Ligji për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës i datës 28 shtator 1989, nuk kanë paraparë dispozita të veçanta lidhur me parashkrimin e kërkesave monetare që lindin nga marrëdhënia e punës, megjithatë kjo nuk do të thotë se instituti i parashkrimit për kërkesat monetare ka mbetur i pa mbuluar me dispozita të tjera ligjore.

Gjykata vlerëson se, për kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile lidhur me kërkesat periodike. Këto rregulla gjinden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978, të njëjtat rregulla gjinden edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2012. Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së). Po ashtu, Ligji i Punës nr. 03/L-212

i cili është në fuqi, nuk parasheh dispozitë të veçantë për parashkrimin në lidhje me pagesat e të ardhurave, por parasheh një afat të përgjithshëm prej 3 viteve të parashkrimit, në lidhje me kërkesat që lindin nga marrëdhënia e punës. Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuara në atë kohë, por edhe në ligjet që tani janë në fuqi.

Prandaj, shihet se parashkrimi për kompensimin e kërkuar në këtë lëndë (për paga të papaguara në shumë prej 15,200.00 € për periudhën gusht 1991 – dhjetor 1997 nga NSH “Banja e Klllokotit”) ishte i rregulluar me LMD-në (1978), i cili ishte ligj ende në fuqi në atë kohë. Vetëm në dhjetor 2012 ligji i aplikueshëm ndryshoi, por edhe LMD-ja ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vjetësh.

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar për paga të papaguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me pagat e pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Sipas shkresave të lëndës dhe pohimeve të vet ankuesit, i njëjti kërkesën për kompensimin e pagave të papaguara (për të ndjerin) për periudhën gusht 1991 – dhjetor 1997, e ka parashtruar në Autoritetin e Likuidimit më 17 janar 2011, që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm se ishte parashkuar.

Gjykata është plotësisht në dijeni për rastet e tilla dhe ka marr parasysh pretendimet e ankuesit për largimin e tij nga puna në bazë të diskriminimit (si të gjithë punëtorëve të tjerë shqiptarë, të larguar në atë kohë nga aplikimi i masave të dhunshme), por nuk ka mundur të ofroj një zgjidhje tjetër ligjore, sa i përket kompensimit të kërkuar për paga të papaguara për periudhën kohore 1991 – 1997, kjo pasi ka kaluar një kohë jashtëzakonisht e gjatë nga ai moment deri në momentin e paraqitjes së kërkesës së tij në procedurë të likuidimit.

Gjykata gjithashtu nuk e mohon faktin (siç theksohet nga ankuesi) se dëshmitë e inicimit të kundërshtimeve nga punëtorët e NSH-së në gjykatën e atëhershme mund të jenë djegur apo asgjësuar gjatë luftës si dhe parashtrimi të padisë në Gjykatën Komunale në Viti sipas lëndës C. nr. 152/06, që mund të jetë dorëzuar nga punëtorët e NSH-së, por të njëjtat nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe, përveç lënies në fuqi të vendimit të kundërshtuar siç edhe u arsyetua më lartë. Një interpretim i tillë njëherit është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit në lidhje me raste të tilla dhe këtë NSH (AC-I-21-0281, AC-I-21-0462, AC-I-22-0651, etj.).

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore në shumë prej 30.00 € për ankesën e parashtruar dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar